

*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 22.04.2023*

*Data.22.04.2023*

*Ora.12:09*

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve të koalicionit  
“Për reforma, integrim dhe institucione të konsoliduara” ndaj personave  
përgjegjës, për raportimin e veprimtarive publike, për zgjedhjet për organet e  
qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ:**
- **Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve** **Z.Illirjan Celibashi,**
- **Stafi KQZ-së:** **Y. Merkaj, M. Koja, E.Meta, V.Ballgjini**  
**Parti Politike:** **PDIU, PD, BF, APLZHK, PDS, P.Gjelbër**  
**OJQ:** **KRIIK, ODIHR**

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita, të gjithëve! Atëherë në seancën e sotme publike kemi për shqyrtim në rendin e ditës projektvendimin që lidhet me shqyrtimet administrative mbi denoncime të koalicionit “Për reforma, integrim dhe insitucione të konsoliduara” ndaj personave përgjegjës për raportim të veprimtarive publike; kemi projektvendime që lidhen me përcaktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do t’u shpërndahet si paradhënie partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 14 majit 2023; kemi miratimin e modelit të aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe partisë politike që përfiton fonde për këto zgjedhje nga buxheti i shtetit; kemi projektvendime që

1

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 22.04.2023*

lidhen me shqyrtimin e disa kërkesave për akreditim, kryesisht nga media, akreditim vëshguesish për këto zgjedhje, dhe kemi të mbartura çështjet që kanë të bëjnë me caktimin e partive politike, që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, po këtë besoj se do ta shtyjme, sepse akoma nuk kemi marrë përgjigje nga Kuvendi për shkresën që i kemi dërguar, apo jo? Dhe kemi projektvendimin për dhënie autorizimi për ndryshim të vendndodhjes së disa qendrave të votimit për Bashkinë e Tiranës dhe Bashkinë e Bulqizës. E shtymë për të bërë disa verifikime dhe vlerësime. Dakord. Atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin administrativ të disa denoncimeve të bëra nga organizata KRIK, mbi veprimtarinë e institucioneve publike gjatë kësaj periudhe.

*Znj. M. Koja:* Atëherë sot jemi për të shpallur vendimin për shqyrtimin administrativ të denoncimeve me nr. 208, 209, 211 dhe 323, të koalicionit “Për reforma, integrim dhe insitucione të konsoliduara”, ndaj kryetarëve të disa bashkive për shkelje administrative të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore në kuadër të zgjedhjeve të 14 majit. Konkretisht, KRIK-u ka denoncuar Bashkinë e Patosit për 2 veprimtari, denoncimet respektive me nr. 208, 209 ID, sipas sistemit të KQZ-së. Në denoncim pretendohet se në datën 11 mars Bashkia e Patosit ka postuar në faqen e vet një postim në lidhje me një aktivitet të zhvilluar në fushën e bujqësisë me prezencë të kryebashkiakes, Balilaj, së bashku me drejtues politikë të qarkut: zotin Balla, deputeten e zonës, zonjën Dhima, në serën e një fermeri. Gjithashtu, referuar denoncimit me nr. ID 209 pretendohet se në datën 15 mars Bashkia e Patosit ka postuar në faqen e vet në facebook sërish një angazhim në fushën e bujqësisë,

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 22.04.2023*

vazhdojnë takimet me fermerët për t'u njohur me ecurinë e veprimtarive të tyre publike, sfidave që kanë hasur dhe kërkesat specifike që ata mund të kenë, e të tjera si këto. Në kuadër të hetimit administrativ vërtetohet se këto 2 veprimtari janë raportuar brenda afatit ligjor në faqen e dedikuar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Fakti që pjesëmarrës në këto aktivitete kanë qenë deputetë, në vlerësimin tonë nuk e bën detyruesisht veprimtarinë në keqpërdorim apo shpërdorim të burimeve publike, për sa kohë, nga sa verifikohet në informacionin e administruar në këto rrjete sociale, nuk ka patur thirrje për të votuar ndonjë mënyrë të caktuar nga prezenca e deputetëve apo e kryetarit të bashkisë, nuk ka postera apo materiale të tjera propogandistike në favor të një subjekti politik dhe në këtë kuadër mendojmë që nuk jemi përpara shkeljeve të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator. Gjithashtu, denoncimi me nr. ID 211 ndaj Bashkisë së Dibrës ku pretendohet se në datën 10 mars 2023 është postuar një aktivitet me deputetin Lavdërim Krrashi, ku është inspektuar faza përfundimtare e punimeve për ndërtimin e Urës së Çikut e të tjera si këto. Gjithashtu, edhe në këtë rast konfirmojmë që veprimtaria është raportuar brenda afatit ligjor dhe prezenca e këtyre deputetëve, siç pretendon bashkia, ka qenë rastësore dhe, nga se verifikohet, edhe në këtë rast nuk kemi as përdorim të materialeve propogandistike dhe as thirrje për të votuar në favor të subjektit zgjedhor. Kemi administruar denoncimin me nr. 323 ID kundër Bashkisë së Roskovecit. Në denoncim pretendohet se kryetarja e Bashkisë së Roskovecit ka postuar në faqen e vet në facebook: "Pamë nga afër punën që vijon me ritme të shpejta për rikonstruksionin e rrugës në Strumë". Në përgjigje të kërkesës sonë për informacion edhe në rastin e Bashkisë së Roskovecit, vërtetohet se ky aktivitet nuk ka aspekt politik në mbështetje të subjektit zgjedhor, kështu që

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*



**Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 22.04.2023**

edhe për rastin e Bashkisë së Roskovecit mendojmë që nuk jemi përpara shkeljeve dhe keqpërdorimit të burimeve publike. Në kuadër të këtij hetimi propozojmë pushimin e procedimit administrativ dhe moskonstatimin e shkeljes.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë edhe një herë për ta përmbledhur, në lidhje me këto 2 raste, veprimtaritë janë të raportuara. Në vëmendje prej denoncuesve është sjellë fakti që në këto aktivitete të zhvilluara nga institucionet publike, respektivisht nga kryetarët e bashkive ka patur prani edhe të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të cilët lidhen me zonën zgjedhore ku janë zgjedhur.

**Znj M. Koja:** Një pjesë po, një pjesë kanë qenë të rastësishëm.

**Z. I. Celibashi:** Po thoni që nuk ka patur deklarime politike ose elektorale nga kryetari i bashkisë, nga deputetë apo nga pjesëmarrës të tjerë dhe veprimtaria është lidhur me aktivitetin që është dashur të kryejë kryetari i bashkisë, të themi.

**Znj. M. Koja:** Dhe kanë qenë veprimtari të raportuara në faqe, në përmbushje të detyrimeve ligjore.

**Z. I. Celibashi:** Po, kemi ndonjë diskutim në lidhje me këtë? Përfaqësues të këtyre insitucioneve nuk ka sot këtu prezent.

**Znj. M. Koja:** Jo, fill janë dëgjuar, është përmbushur komplet faza e hetimit administrativ.

**Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa**



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 22.04.2023*

**Z. I. Celibashi:** Mirë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim, unë jam dakord që të vendosim pushimin, edhe pse me siguri prania e atyre deputetëve aty nuk është dhe fare kaq rastësore, por gjithsesi sa kohë që në këto aktivitete kanë munguar adresimet politike dhe elektorale, formalisht mendoj që nuk ka vend për të vendosur ndonjë sanksion ndaj drejtuesve të këtyre bashkive, meqenëse edhe janë raportuar si aktivitete të këtyre institucioneve. E kemi bërë dhe më parë këtë diskutim në lidhje me rolin e deputetëve dhe janë në gjithë të drejtën e tyre që të lëvizin në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë edhe pse ndoshta jo pak prej nesh e kuptojnë shumë mirë që qëllimi atje është edhe tej atij për të qenë prezent në një veprimtari të një institucioni publik edhe brenda këtij profili. Mirë, faleminderit!

**Vendimi nr. 396**

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 22.04.2023*

*Data.22.04.2023*

*Ora.12:17*

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 261 ID, 262 ID, 273 ID, 274 ID, 275 ID, 276 ID , 288 ID, 289 ID, 291 ID, 292 ID, 293 ID, 296 ID , 297 ID, 298 ID, 305 ID, 307 ID, 309 ID, 310 ID, 311 ID, 312 ID, 313 ID, 315 ID, 316 ID, 317 ID, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj personave përgjegjës, për raportimin e veprimitarive publike, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 Maj 2023”*

**PJESËMARRJA :**

- KQZ:
- Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi,**
- Stafi KQZ-së: **Y. Merkaj, M. Koja, E.Meta, V.Ballgjini**  
Parti Politike: **PDIU, PD, BF, APLZHK, PDS, P.Gjelbër**  
OJQ: **KRIIK, ODIHR**

*Z. I. Celibashi:* Mirë, Mirë, faleminderit! Kalojmë tek ...

*Znj. M. Koja:* Kemi edhe një vendimarrje të dytë për sa u përket disa denoncimeve të tjera ndaj disa insitucioneve, konkretisht është denoncimi me nr. ID 297 kundër Bashkisë së Kavajës për një veprimtari publike të paraportuar. është verifikuar që është zhvilluar një veprimtari dhe nga sa pretendohet dhe parashtrohet nga Bashkia

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*



**Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 22.04.2023**

e Kavajës kjo është një veprimtari jo e organizuar prej saj, por ka qenë e ftuar nga studentë të universitetit të Tiranës, kështu që ne mendojmë që në këto kushte, e para, kryetari i bashkisë ka qenë i ftuar në këtë veprimtari, por nga ana tjetër ne vlerësojmë që ajo më shumë sesa veprimtari publike për t'u raportuar, është një veprimtari me karakter politik dhe në këtë kuadër nuk mbartet detyrimi për ta raportuar në faqen e dedikuar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në vijim të denoncimeve kundër Bashkisë së Kavajës janë dhe disa denoncime të tjera, konkretisht kundër Bashkisë së Pogradecit, Bashkisë së Vorës, Devollit, Bashkisë së Durrësit, janë disa denoncime kundër Bashkisë së Malësisë së Madhe, Bashkisë së Rrogozhinës, Bashkisë së Prrenjasit, Bashkisë së Gjirokastrës, Bashkisë së Kukësit, Bashkisë së Lushnjës dhe Bashkisë së Kuçovës. Të gjitha këto denoncime janë në kuadër të publikimeve në faqen e facebook-ut të bërë nga kryetarët e këtyre bashkive dhe janë veprimtari me karakter politik në kuadër të zgjedhjeve të ardhshme. Në këtë kuadër ne mendojmë që nuk mbartet detyrimi për t'u raportuar në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ne bëmë një verifikim edhe në faqet zyrtare..

**Z. I. Celibashi:** Kush është pretendimi, që nuk janë raportuar dhe duhet të ishin raportuar?

**Znj. M. Koja:** Pretendimet janë që janë të paraportuara dhe janë edhe me përmbajtje elektorale. Ne bëmë një verifikim dhe çekuam faqen zyrtare të këtyre bashkive dhe nga sa verifikohet nuk janë ripostuar në faqen zyrtare të institucionit postimet me përmbajtje politike elektorale të kryetarëve të bashkive.



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 22.04.2023*

**Z. I. Celibashi:** Pra, po thua që kanë qenë aktivitete politike, në të cilat nuk ka patur përdorim të fondeve apo të aseteve publike dhe nuk kanë patur për qëllim zhvillimin e një aktiviteti brenda portofolit institucional të institucionit përkatës, por kanë qenë thjesht veprimtari politike. Denoncimi lidhet me faktin që këto veprimtari politike janë pasqyruar në rrjetin social të drejtuesve të këtyre insitucioneve, po në llogaritë e tyre personale, që gjithmonë ngelet diskutimi ndërmjet jo vetëm nesh dhe atyre që e sjellin në vëmendje të KQZ-së këtë fakt, por edhe të tjerëve, nëse këto llogari janë të institucionit apo të individit, dakord.

**Znj. M. Koja:** Ndërkohë, ne nuk mund të shpallim sot vendimin për periudhën e monitorimit nga data 6 deri në 13 prill 2023.

**Z. I. Celibashi:** Kështu që edhe për ato raste nuk do të ketë sanksione.

**Znj. M. Koja:** Ndërsa për sa i përket periudhës së monitorimit 6-13 prill, ne mendojmë të mos e shpallim sot vendimin për sa kohë kemi administruar 31 denoncime në lidhje me veprimtari që i përkojnë kësaj periudhe. Kemi filluar hetimin administrativ për këto denoncime dhe në përfundim do të vlerësojmë edhe periudhën e monitorimit 6-13 prill 2023. Ndërkohë edhe për sa i përket periudhës pasuese të monitorimit 14-21 prill, për të cilën jemi në fazën e shqyrtimit, edhe për këtë periudhë kemi administruar rreth 52 denoncime, kështu që edhe ato do të bëhen pjesë e shqyrtimit administrativ të kësaj periudhe monitorimi.





*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 22.04.2023*

**Z. I. Celibashi:** Po, do të thotë që në rastet kur ne do të bëjmë shqyrtimet e raporteve periodike të institucioneve do të përfshijmë në këtë shqyrtim edhe denoncimet e ardhura deri në momentin që ne nuk kemi vendosur të përfshijmë edhe denoncimet e organizatave të ndryshme apo edhe partive politike për atë periudhë veprimtarie.

**Vendimi nr. 395**

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 22.04.2023*

*Data.22.04.2023*

*Ora.12:23*

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për përcaktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do t’u shpërndalet si paradhënie partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ:**
- **Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve**      **Z.Illirjan Celibashi,**
- **Stafi i KQZ-së:**                      **Y. Merkaj, M. Koja, E.Meta, V.Ballgjini**  
**Parti Politike:**                      **PDIU, PD, BF, APLZHK, PDS, P.Gjelbër**  
**OJQ:**                                      **KRIIK, ODIHR**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me caktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do t’u shpërndalet si paradhënie partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Po, zoti sekretar.

**Z. Y. Merkaj:** Faleminderit! Neni 19, pika 1, shkronjat “k” dhe “n” të Kodit Zgjedhor parashikojnë kompetencën e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për përcaktimin e sasisë së fondit publik që do t’u shpërndalet si paradhënie partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në zgjedhje. Gjithashtu, neni 96 shkronja “a” e Kodit Zgjedhor parashikon se burime të financimit të fushatës për subjektet

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*



**Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 22.04.2023**

zgjedhore janë fondet e dhëna nga buxheti i shtetit për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore. Nenet 98 dhe 130 të Kodit Zgjedhor përcaktojnë mënyrën e përllogaritjes për ndarjen e fondit dhe shumën që i takon secilës parti që do të marrë paradhënie. Me vendimin nr. 30 të vitit 2028 të Kuvendit të Shqipërisë është përcaktuar se fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për këto zgjedhje është 100 milionë. Referuar këtyre dispozitave kemi përgatitur edhe projektvendimin për përcaktimin e sasisë së fondit publik që do t'u shpërndahet partive politike. Qëllimi i këtij projektvendimi është të përcaktojë mënyrën e përllogaritjes dhe kriteret për shpërndarjen e fondeve paradhënie për subjektet politike të regjistruara, për caktimin e subjekteve zgjedhore që u lind e drejta të përfitojnë fonde të paradhënies, si dhe modalitetet që u lindin subjekteve zgjedhore për pranimin e këtyre fondeve. Neni 180 i Kodit Zgjedhor, dispozita transitore për financimin e buxhetit, përcakton se për zgjedhje para të përgjithshme pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, përllogaritja e shpërndarjes së fondeve, paradhënia do të bëhet në bazë të rezultatit të zgjedhjeve në shkallë vendi për zgjedhjet vendore të vitit 2015 dhe vitit 2017. Duke qenë se zgjedhje para të përgjithshme për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të Kodit Zgjedhor, në tetor të 2020-s, janë zgjedhjet e datës 14 maj 2023, përllogaritja e numrit të votave të vlefshme bëhet duke marrë numrin më të lartë të votave për secilën parti që ka përfituar mbi 1% të votave për zgjedhjet 2015-2017 dhe 2019. Për zgjedhjet e datës 14 maj 2023 janë regjistruar 44 parti politike si subjekte zgjedhore. 6 parti politike nga këto janë regjistruar në dy koalicione dhe përkatësisht koalicioni “Aleanca Liberale e Djathtë”, ku në përbërje janë: Partia Balli Kombëtar Demokrat, Partia Bashkimi Liberal Demokrat dhe Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar, dhe koalicioni “Bashkë Fitojmë”, ku në përbërje janë: Partia e

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Datë 22.04.2023*

Lirisë, Partia Demokristiane e Shqipërisë dhe Partia për të Bashkimi Drejtat e Njeriut. Referuar vendimeve të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për vitet 2015- 2017 dhe 2019 partitë politike që kanë përfituar jo më pak se 1% të votave për zgjedhjet e viteve 2015, 2017, 2019 është sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi edhe projektvendimi. Gjithashtu, në nenin 65, pika 3 të Kodit Zgjedhor parashikohet se në momentin e regjistrimit koalicioni duhet të deklarojë partinë udhëheqëse të koalicionit. Marrëdhëniet midis partive për pjesëmarrjen e koalicionit dhe detyrimet reciproke të tyre rregullohen me marrëveshjen e koalicionit. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga ligji përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Në këto zgjedhje, siç e thamë, është koalicioni “Bashkë Fitojmë”, që ka në përbërje 3 parti politike dhe vetëm 2 përfitojnë fonde, siç është Partia e Lirisë dhe Partia Demokristiane e Shqipërisë. Referuar nenit 65 të Kodit Zgjedhor koalicionit do t’i përlllogariten fondet duke mbledhur fondet e këtyre dy partive. Për sa më sipër, për llogaritje të numrit të votave të vlefshme nga partitë që janë regjistruar për zgjedhje të organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, i cili rezulton se është 1 milion e 785 mijë e 403 vota. Vlera në lekë e një vote llogaritet duke pjesëtuar totalin e shumës së vënë në dispozicion 100 milionë lekë me votat vlefshme 1 milion e 785 mijë e 403 vota. Rezultati pas pjesëtimit përcakton vlerën në para të një vote, e cila ka dalë 56 lekë e 0097. Referuar pikës 3 të nenit 88 të Kodit Zgjedhor përlllogaritja e shumës që i takon secilës parti bëhet duke shumëzuar vlerën në para të një vote, e cila është 56 lekë, me numrin më të lartë të votave të vlefshme që ka marrë secila parti në këto zgjedhje. Për sa më sipër, shuma totale që përfiton secila parti politike e regjistruar për zgjedhjet e datës 14 maj 2023, si ndihmë financiare për fushatën zgjedhore, është numri më i lartë votave

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.22.04.2023*

të vlefshme që partia politike ka fituar, shumëzuar me vlerën në para të një vote, duke i zbritur sanksionet administrative me gjoba të vendosura nga KQZ-ja dhe Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve. Përkatësisht për subjektin zgjedhor Partia Demokratike, pasi hiqet gjoba që i është vënë nga KAS-i me vendim numër 7, datë 25.1.2023 prej 600 mijë lekësh, vlera përfundimtare që përfiton është 24,963,584.24 lekë, plus subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike e cila përfiton ndihmë financiare pasi t'i hiqet gjoba prej 500 mijë lekësh e vënë nga KAS-i me vendim numër 7, datë 25.01.2023 përfundimisht shuma që përfiton 638,798 lekë, për subjektin zgjedhor Partia Demokristiane e Shqipërisë pasi i hiqet gjoba prej 100 mijë lekës e vënë nga KAS-i, shuma që përfiton është 1,035,373.92 lekë, për subjektin zgjedhor Partia Social-Demokrate, duke marrë parasysh që i është vendosur një gjobë e cila është 2,129,360 lekë, shuma që përfiton është më e vogël se kjo, kështu që kjo parti del debitore në shumën prej 879,222 lekësh, për subjektin zgjedhor Partia Fryma e Re Demokratike, pasi do t'i mbahet shuma prej 485,332 lekësh të vendosura me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve shuma që përfiton është 1,194,064 lekë, për subjektin zgjedhor Partia Socialiste shuma që përfiton është 42,833,466.73 lekë, për subjektin zgjedhor Partia Republikane shuma që përfiton është 3,012,429.13 lekë, për subjektin zgjedhor Aleanca Progresiste LZHK shuma që përfiton është 1,100,255 lekë, për subjektin zgjedhor Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet shuma që përfiton është 4,260,606.71 lekë, për subjektin Partia Demokracia Sociale përfiton 1,123,779.90 lekë, për subjektin zgjedhor Partia e Lirisë e cila është partia udhëheqëse e Koalicionit Bashkë Fitojmë, shuma që përfiton është 14,558,202 lekë shtuar edhe vlerën e Partisë Demokristiane shuma që përfiton është 15,594,215 lekë, për subjektin zgjedhor Partia Gjellbër shuma që përfiton është 797,915 lekë, për subjektin zgjedhor Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë shuma që përfiton është 448,974 lekë, për subjektin zgjedhor Aleanca

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.22.04.2023*

Arbnore Kombëtare shuma që përfiton është 532,820 lekë, dhe për subjektin zgjedhor Partia Uniteti Kombëtar si ndihmë financiare për fushatën e datës 14 maj është 562,618 lekë. Bashkëngjitur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe tabelat përkatëse. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësues të partive politike, diskutime në lidhje me këtë pikë? Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

**Z. I. Sefa:** Unë jam njohur dhe më parë me projektvendimin e propozuar nga administrata e KQZ-së, praktikisht një pyetje kisha, me shumë të drejtë Komisioneri i ka zbritur fonde Partisë Demokratike për pasojë të gjobës që ka marrë prej 600 mijë lekësh nga vendimmarrja e Komisionerit, por nuk shoh partitë e tjera që kanë marrë një gjobë shumë herë më të mëdha se Partia Demokratike si Partia Socialiste e Shqipërisë, në dijeninë time është dënuar me 5 mln lekë dhe kjo nuk është zbritur nga fondet që propozon Komisioneri.

**Znj. V. Ballgjini:** Të gjitha partitë e tjera të cilat nuk janë të përfshira në këtë projektvendim e kanë shlyer detyrimin ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e kanë bërë pagesën.

**Z. I. Celibashi:** Dakord, diskutime të tjera në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës? Të lutm kalo këtu përpara dhe për efekt të regjistrimit, ju lutem prezantohuni edhe

**Përfaqësuesi i PSD:** Jam përfaqësuesi Partisë Demokratice Sociale, këtu thoni në bazë të përllogaritjes të numrit më të lartë të votave që ka marrë një parti mbi 1 %,

*Zbardi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.22.04.2023*

atëhere kemi numrin më të lartë të votave 27,865 me 3.66% në zgjedhjet e vitit 2019, pse na është bërë llogaritja për vitin 2015.

**Z. I. Celibashi:** Atëhere, dispozita të cilës do t'i referohemi për përcaktimin e shumës që partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje përfitojnë për këto zgjedhje është neni 180 i Kodit Zgjedhor, biem dakord për këtë besoj, është dispozita tranzitore, dhe dispozita tranzitore në pikën e parë, pra neni 180 thotë për llogaritja bëhet në bazë të rezultateve të zgjedhjeve në shkallë vendi për zgjedhjet vendore të vitit 2015 dhe zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017, pra ky është rregulli bazë, që një parti politike e cila regjistrohet në këto zgjedhje përfiton fonde me kushtin që të ketë marrë pjesë në zgjedhjet e vitit 2015 ose në zgjedhjet e vitit 2017. Pika e dytë thotë për secilën parti përfshihet në llogaritje shifra, pra për secilën parti që ka marrë pjesë në këto dy zgjedhje përfshihet shifra që pasqyron numrin më të lartë të votave që partia ka marrë në njërin nga këto dy zgjedhje, ku ajo është jo më e vogël se 1%, pra duhet të kesh 1% të votave edhe më shumë, të kesh marrë pjesë në një nga këto dy zgjedhje që të kualifikohesh për të përfituar fonde. Nëse ke marrë pjesë vetëm në një nga zgjedhjet pra në 2015 ose 2017, do të merret rezultati ose i 2015 ose i 2017. Nëse ke marrë pjesë në dy zgjedhje do të merret për llogari rezultati më i mirë që ke marrë, ose 2017 ose 2015. Fjalja e dytë, e paragrafit të dytë, të nenit 180 thotë, në për llogaritje, pra të partive që përfitojnë fonde, përfshihet edhe rezultati i subjekteve zgjedhore që nuk kanë marrë pjesë në ato zgjedhje, pra fjalja e dytë e kësaj pike flet për ato parti të cilat nuk kanë marrë pjesë në ato zgjedhje, nëse ke marrë pjesë në ato zgjedhje, qoftë edhe në njërin prej tyre, zbatohet paragrafi i parë, i nenit 180, nëse je parti e cila nuk ke marrë pjesë në ato zgjedhje zbatohet fjalja e dytë e paragrafit të dytë. Juve nuk jeni në këto kushte, ju jeni në kushtet ku keni marrë pjesë në zgjedhjet e 2015, pra nuk trajtohet rasti juaj me rast përjashtimor, jeni në rastin ku keni marrë

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.22.04.2023*

pjesë në një nga këto dy zgjedhjet, pra 2015 dhe 2017, kështu që për ju nuk llogaritet rezultati më i mirë ndërmjet 2019 dhe 2015, për ju merret rezultati i 2015 automatikisht. Përjashtimi është për ato parti që nuk kanë marrë pjesë në asnjë nga ato zgjedhje, ju nuk jeni te kjo bashkësi. Diskutime të tjera? Nuk kemi. Mirë, faleminderit, atëhere edhe njëherë sipas përlllogaritjeve që kemi bërë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, janë partitë vijuese të cilat përfitojnë fonde me shumat respektive: Partia Demokratike 24,963,584.84 lekë, Partia Republikane 3,012,429.13 lekë, Partia Aleanca Progresiste LZHK 1,100,255.80 lekë, Partia Socialiste e Shqipërisë 42,883,466.73 lekë, Partia e Lirisë 15,594,215.8 lekë, Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet 4,260,606.71 lekë, Fryma e Re Demokratike 1,194,064,75 lekë, Partia Demokracia Sociale 1,123,779,90 lekë, Partia Social Demokrate nuk përfiton, Bindja Demokratike 639,798,69 lekë, Partia e Gjelbër 797,915.09 lekë, Aleanca Demokristiane e Shqipërisë 448,974,27 lekë, Aleanca Arbnore Kombëtare 532,820.88 lekë, Partia Uniteti Kombëtar 562,618.08 lekë. Në total janë 97,064,530.08 lekë.

**Vendimi nr. 397**

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.22.04.2023*

22.04.2023  
Ora 12.38

**RENDI I DITËS**

*Projektudhëzim “Për miratimin e modelit të aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe partisë politike që përfiton fonde nga buxheti i shtetit dhe Komisionit Oendoror i Zgjedhjeve”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Staf i KQZ:      **Z. Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta,  
V. Ballgjini**
- **Parti Politike:**      **PDIU, PD, BF, PDS, PGJ, APLZHK**
- **OJQ:**      **KRIIK, ODIHR**

*Z. I. Celibashi:* Faleminderit, kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës.

*Z. Y. Merkaj:* Po, neni 19, pika 1, e Kodit Zgjedhor ka parashikuar në kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të lidhur marrëveshje dhe kontrata me të tretët, për të monitoruar ose kontrolluar zbatimin e tyre, gjithashtu neni 88, i Kodit Zgjedhor përcakton fondet nga buxheti i shtetit për financimin e partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje. Sipas dispozitave kemi përgatitur dhe projektudhëzimin për miratimin e modelit të aktmarrëveshjes për bashkëpunim ndërmjet Komisionerit Shtetëror të zgjedhjeve dhe partisë politike. Qëllimi i kësaj aktmarrëveshje është angazhimi i palëve për përdorimin e fondeve të përfituara nga buxheti i shtetit që i

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.22.04.2023*

jepet partisë politike, në zbatim të gjitha kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Partitë politike që përfitojnë fonde nga buxheti i shtetit, marrin përsipër të pranojnë fondin e dhënë për ta përdorur atë në zbatim të të gjitha kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, të pranojnë monitorimin e shpenzimeve të fondeve të dhëna për të si subjektit zgjedhor dhe kandidatëve të tij, të respektojnë të gjithë ndalesat dhe kufizimet e parashikuara në Kodin Zgjedhor, se në rast se partia politike nuk zbaton përcaktimet e bëra në neni 88, paragrafi 7, i Kodit Zgjedhor, atëhere përjashtohet nga e drejta për te fituar fonde publike për një periudhë jo më pak se 5 vjet, përveçse kur shlyen detyrimet bashkë me gjobën. Bazuar në nenin 92/4 dhe 92/6 të Kodit Zgjedhor, partia politike pranon monitorimin e aktivitetit të saj gjatë fushatës zgjedhore dhe 4 muaj para datës së zgjedhjeve, panvarësisht faktit se nëse regjistrohet më vete si subjekt zgjedhor apo në kuadër të një koalicioni zgjedhor. Përsa më sipër kemi përgatitur dhe aktmarrveshjen, ku palët me vullnet të lirë marrin përsipër të respektojnë dhe të përmbushin detyrimet e kësaj aktmarrveshjeje. Risia në këtë projektudhëzim është ndryshimi i formatit të aktmarrveshjes nga formati i mëparshëm. Bashkëlidhur kemi projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe formatin e aktmarrveshjes. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Përfaqësues të partive politike në lidhje me këtë pikë? Po përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

**Z. I. Sefa:** Ideja është që të kemi një propozim konkret, një dokument që ta shohim dhe të japim një opinion.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.22.04.2023*

**Z. I. Celibashi:** Është bashkalidhur këtij dhe ndërkohë nëse nuk gaboj i është dërguar dhe përfaqësuesëve të partive politike me email, ditë më parë, por ndërkohë duhet të jetë bashkëlidhur këtij projektakti.

**Z. I. Sefa:** Bashkëlidhur projektvendimit të kësaj?

**Z. I. Celibashi:** Po,po. Jemi dakord të vazhdojmë apo doni

**Z. I. Sefa:** Përsa kohë që është një aktmarrveshje, është kuadër, nuk besoj.

**Z. I. Celibashi:** Mirë faleminderit. Atëhere, miratohet dhe përmbajtja e draftit të aktmarrëveshjes ndërmjet Komisionetir Shtetëror të Zgjedhjeve dhe partive politike, në lidhje me fondet që këto të fundit përfitojnë nga buxheti i shtetit në kuadër të fushatës elektorale për zgjedhjet e 14 majit 2023.

**Udhëzimi nr. 3**

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.22.04.2023*

22.04.2023  
Ora 12.41

**RENDI I DITËS**

**4. Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesave të televizioneve “Star Plus”, “Syri TV”, “Klan TV” dhe media online “Albanian Post”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2. Stafi KQZ:

Z. Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta,  
V. Ballgjini

• **Parti Politike:**

PDIU, PD, BF, PDS, PGJ, APLZHK

• **OJQ:**

KRIIK, ODIHR

**Z. I. Celibashi:** Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesave të televizioneve “Star Plus”, “Syri TV”, “Klan TV”, dhe media online “Albanian Post” për akreditim vëzhguesish për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore datë 14 maj 2023.

**Z. Y. Merkaj:** Televizioni “Star Plus” ka paraqitur kërkesë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për akreditimin e 13 gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Televizioni “Syri TV” ka paraqitur kërkesë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për akreditimin e 58 gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre, gjithashtu televizioni “Klan Tv” ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 68

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.22.04.2023*

gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Media online “Albanian Post” ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 7 gazetrëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Të gjitha kërkesat dhe dokumentacionet e këtyre mediave plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenit 6, të Kodit Zgjedhor dhe si të tilla i kërkojmë Komisionerit ta akreditojë sipas kërkesave të tyre. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Besoj përfaqësuesit e partive s’keni diskutim në lidhje me këtë pikë, atëhere miratojmë akreditimin e vëzhguesëve për televizionet “Star Plus”, “Syri TV”, “Klan TV”, si dhe për median online “Albanian Post”.

**Vendimi nr. 398**

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.22.04.2023*

22.04.2023  
Ora 12.42

**RENDI I DITËS**

5. Projektvendim “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numëritmit të Votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Staf i KQZ:      **Z. Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta,  
V. Ballgjini**
- **Parti Politike:**      **PDIU, PD, BF, PDS, PGJ, APLZHK**
- **OJQ:**      **KRIIK, ODIHR**

**Z. I. Celibashi:** Po, projektvendimi për caktimin e partive që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt e shtyjme derisa të marrim përgjigje nga Kuvendi i Shqipërisë. Po.

**Z. Sh. Sulo:** Po, faleminderit zoti Kryetar. Ne na u vunë në dispozicion materialet nga Kuvendi i Shqipërisë, është shkresa e datës 20.04.2023 dhe mendoj se dokumentacioni e informacioni i kërkuar dhe nga kërkesa e përfaqësuesit.

**Z. I. Celibashi:** Po ne nuk e kemi, besoj pala tjetër nuk e ka kështu që

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.22.04.2023*

**Z. E. Kaziaj:** Jo vetëm aq, por nuk kanë shteruar të gjitha pyetjet e bëra nga ana juaj.

**Z. I. Celibashi:** Do ta shtyjmë për ditën e hënë. Derisa ta marrin zyrtarisht këtë dokument. Faleminderit.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.22.04.2023*

22.04.2023  
Ora 12.44

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 1977/00, QV nr. 1977/01, QV nr. 1977/02, QV nr. 1977/03, QV nr. 2021/00, QV nr. 2021/01, Bashkia Tiranë, QV nr. 1080/00, Bashkia Bulqizë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.*

**PJESËMARRJA :**

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2. Staf i KQZ:

Z. Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta,  
V. Ballgjini

• **Parti Politike:**

PDIU, PD, BF, PDS, PGJ, APLZHK

• **OJQ:**

KRIIK, ODIHR

*Z. I. Celibashi:* Vazhdojmë te pika e fundit për autorizimin.

*Z. Y. Merkaj:* E kemi shtyrë dhe këtë projektvendim pasi është bërë verifikimi sipas kërkesave të përfaqësuesit të Koalicionit Bashkë Fitojmë. Pas verifikimit konstatohet se për njësinë administrative numër 9, kryetari kësaj njësie administrative gabimisht e ka kaluar te Policia Bashkiake këtë dhe është korrigjuar nga ana jonë Qendra e Votimit nga Policia Bashkiake të shkolla ‘7 Marsi’ në lidhje me njësinë administrative numër 11, kryetari kësaj njësi kishte caktuar një ambient privat Qendër Votimi numer 2021/01, ideja është që pasi shkuam për të lidhur

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.22.04.2023*

kontratën e qerasë për këtë Qendër Votimi u vumë në dijeni të faktit që ky ambjent është në konflikt gjyqësor dhe për të shmangur çdo pasojë të pakëndëshme, është propozuar lokali i zotit Xhevahir Hysa. Këto ishin verifikimet kështu që mendojmë që i plotësojnë kushtet për t'u përdorur si Qendra Votimi për këto zgjedhje. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Dakord, përfaqësues të partive lidhur me këtë pikë? S'kemi ndonjë gjë për të shtuar përveçse atij diskutimit që ne bëmë. Mirë, do ta japim autorizimin për ndryshimin, por ndërkohë do të proçedojmë me vlerësimin për sanksion administrativ për këtë çështje, në rregull? Dhe pasi të bëni gjithë vlerësimin dhe merrni gjithë informacionin, në rregull, dhe ndërkohë partitë politike kanë gjithë të drejtën për të bërë një vlerësim të pavarur dhe ato, në lidhje me vendndodhjen e këtyre Qendrave të Votimit, nëse eventualisht mund të ketë ndonjë problem ose jo, përndryshe jemi të hapur për të bërë ndryshimet përkatëse. Po, përfaqësuesi Partisë Demokratike.

**Z. I. Sefa:** Për KZAZ-në 39 i kam dërguar Sekretarit të Përgjithshëm, një informacion që më ka ardhur nga anëtarët e KZAZ-së, nuk e di nëse ka ndonjë qëndrim në lidhje me atë se kishte disa shqetësime që ishin ngritur në lidhur me Qendrën e Votimit.

**Z. Y. Merkaç:** Është pikërisht KZAZ 39, është njësi bashkiake numër 9, që sapo relatua.

**Z. I. Celibashi:** Përmban këtë, në rregull, dakord. Dakord, diskutime të tjera? Po, përfaqësuesi Partisë Demokratike.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.22.04.2023*

**Z. I. Sefa:** I nderuar zoti Komisioner, unë kisha një kërkesë për ju duke pas parasysh vendimarrjet e fundit të KAS dhe Kolegjit Zgjedhor, kërkoj që nga ana e këtij komisioni të bëhet një fushatë sensibilizuese për pasqyrimin e fletës së re të votimit sipas vendimmarrjeve të dy organeve të KAS dhe të Kolegjit Zgjedhor. Duke qënë se Komisioneri ka publikuar vendimarrjen e tij të mëparëshme dhe ka patur një ndryshim për këtë, kërkoj që të ketë një fushatë sensibilizuese në lidhje me fletën e votimit në mënyrë që votuesit të jenë të qartë dhe në lidhje me atë çka do kenë në 14 maj përpara duarve të tyre.

**Z. I. Celibashi:** Po, këtë do ta bëjmë, kemi filluar të punojmë që dje për të prezantuar tashmë në mënyrë përfundimtare përmbajtjen e fletëve të votimit për të gjitha bashkitë, do të jetë në të gjitha mediat, në rrjetet sociale do të ketë publikim të informacionit në lidhje me përmbajtjen e fletës së votimit, dhe natyrisht edhe spote të ndryshme radio-televizive apo dhe forma të tjera të njoftimit mbi përmbajtjen e fletëve të votimit. Mirë faleminderit për diskutimet. Seança mbyllet, ditë të mbarë!

**Vendimi nr. 399**

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*

